

Stacionin e Parë Policor në Novi Sad. Jetonte në qytezën Titel, së bashku me bashkëshorten Jadranka dhe prindërit e vetë. Në shtatorin e vitit 1998, ai ka qenë në përbërje të forcave policore, të cilat ishin të stacionuara në bjeshtën e *Çiçavicës/Çiçavica*. E kanë plagosur në zonën e fshatit **Dobroshec/Dobroševac** më **22.09.1998**. E transferuan në AMU, ku po atë ditë ndërroi jetë nga pasojat e plagosjes. Dy ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Slobodanin në varrezat e Titelit.

Burimet: deklarata Z.G, FDH-36823; SMIP, *Terroristički.*, III, 513, 939; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 22; KMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; *Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Bexhet (Islam) Karaxha

(20.09.1969, shqiptar nga Çikatova e Vjetër/Staro Čikatovo, komuna e Glogocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Milaim (Fetah) Karaxha

(10.05.1967, shqiptar nga Çikatova e Vjetër/Staro Čikatovo, komuna e Glogocit/Glogovac, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Kushërinjtë Bexheti dhe Milaimi aderuan në UÇK në vitin 1997. Familjet e tyre e kanë braktisur Çikatovën e Vjetër/Staro Čikatovo më 27.05.1998. Familja e Bexhetit ka shkuar në Tërstenik/Trstenik, ndërkaq ajo e Milaimit në Likoshan/Likošane. Në datën 1.09.1998, Bexheti dhe Milaimi shkuan së bashku në Tërstenik/Trstenik, për ta vizituar familjen e Bexhetit. Nuk u kthyen më. Pasi kaluan 12 ditë nga shkuarja e tyre, babai i Bexhetit u nis për në Gllanasellë/Gladno Selo për të ndriçuar fatin e tyre. Disa refugjatë në këtë fshat i kanë thënë se, më **22.09.1998**, në **Gllanasellë/Gladno Selo**, dy pjesëtarë të UÇK-së, anëtarë të familjes Karaxha, kanë rënë në betejë me pjesëtarë të forcave serbe dhe se ishin varrosur në Vrboc/Vrbovac. Më pas, hoxha i këtij fshati i ka treguar vendin ku ishin varrosur Bexheti dhe Milaimi. Në datën 22.08.1999, mbetjet mortore të Bexhetit dhe Milaimit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të

Luftës në Gllanasellë/Gladno Selo.

Burimet: deklarata S.K, FDH-30776; J. Martinsen, *Regjistri.*, FDH-26092.

Hamit (Halit) Lladrovci

(26.05.1920, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Glogocit/Glogovac, punëtor, dhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Kur forcat serbe e nisën ofensivën ndaj Gllanasellës/Gladno Selo më **22.09.1998**, familja e Halitit e ka braktisur fshatin, së bashku me të gjithë bashkëfshatarët të tjerë. Hamiti vendosi të qëndronte në shtëpinë e vet. Dy ditë më vonë, i biri, së bashku me disa pjesëtarë të UÇK-së, u kthye në fshat **[Gllanasellë/Gladno Selo]** për ta vizituar të atin. E gjetën trupin e pajetë të Hamitit në katin e dytë të shtëpisë. Në gjoks i kishte shumë plagë nga plumbat. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e Gllanasellës/Gladno Selo, së bashku me disa pjesëtarë të UÇK-së që po atë ditë kanë rënë në luftime me forcat serbe.

Burimet: deklarata S.L, FDH-19745; HLC, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 193; J. Martinsen, *Regjistri.*, FDH-26092.

Fehmi (Muhamet) Lladrovci

(15.05.1956, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Glogocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevë (Avdyl Krasniqi)

Lladrovci

(1.06.1955, shqiptare nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Glogocit/Glogovac, pjesëtare e UÇK-së)

Shefqet (Sabit) Zeka

(8.08.1977, shqiptar nga Prishtina/Priština, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Fatime (Zeqir) Hetemi

(18.12.1977, shqiptare nga Bistrica, komuna e Leposaviqit/Leposavić, pjesëtare e UÇK-së)

Fehmiu ka qenë student i Fakultetit të Makinerisë në Zagreb. Gjatë viteve të tetëdhjeta, ai, së bashku me bashkëshorten Xhevën, aderoi në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Në vitin 1985, Fehmiu e dënuan në Serbi me dhjetë vjet